

**MBI AKTIVITETIN
E KOMISIONIT TË POSAÇËM
PARLAMENTAR
DHE ZHVILLIMET NË REFORMËN
PËR MIRËQEVERISJEN, ANTIKORRUPSIONIN
DHE SUNDIMIN E LIGJIT**

**KPP – Buletin periodik 09
Shkurt 2025**



**KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR
“PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR MIRËQEVERISJEN,
SUNDIMIN E LIGJIT DHE ANTIKORRUPSIONIN
PËR SHQIPËRINË 2030 NË BASHKIMIN EUROPIAN”**

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit vijoi veprimtarinë e tij edhe gjatë muajit shkurt 2025, kryesisht me takime në kuadër të forumeve të dialogut me qytetarët si dhe me mbledhjet për shqyrtimin dhe miratimin e Dokumentit Analitik për të tri shtyllat: *Mirëqeverisja, Antikorrupsioni dhe Sundimi i ligjit*. Po kështu pati edhe vizita pune jashtë vendit në Komisionin Europian (BE) dhe në zyrat e Open Government Partnership (OGP).

4 shkurt 2025

Komisioni i Posaçëm Parlamentar takim në Berat, shoqëria civile dhe pushteti vendor diskutojnë gjetjet e ekspertëve

Pjesëmarrësit në këtë takim, aktorë të shoqërisë civile, të rinj, qytetarë dhe përfaqësues të institucioneve të pushtetit vendor, u njohën me analizën e realizuar nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë (GENL), metodologjinë e përdorur nga ekspertët për skanimin e situatës në drejtim të mirëqeverisjes, antikorrupsionit dhe sundimit të ligjit, masat dhe mekanizmat e sugjeruara prej tyre për t'u bërë pjesë e Planit Kombëtar të Veprimit, i cili do të finalizohet pas dëgjësave që po zhvillohen në disa qytete të vendit. Në fokus të këtij takimi ishte jo vetëm informimi mbi punën e Komisionit të Posaçëm, por dhe marrja e mendimeve, sugjerimeve dhe komenteve nga aktorë dhe faktorë të ndryshëm të shoqërisë, të cilat do të shërbejnë për përmirësimin e Planit Kombëtar të Veprimit. Deputetja Etilda Gjonaj në fjalën e saj bëri një përmbledhje të punës së deritanishme të Komisionit të Posaçëm, analizës së gjerë profesionale të bërë nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, procesit të konsultimit me ekspertë ndërkombëtarë dhe shqiptarë që jetojnë në diasporë, ku theksoi nevojën për angazhimin e të gjithë aktorëve të shoqërisë e sidomos të rinjve në parandalimin dhe ndryshimin e qasjes ndaj fenomenit të korrupsionit.

Prof. asoc. dr. Enkelejda Olldashi, pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, bëri një përmbledhje të komponenteve të analizës për fushën e antikorrupsionit si dhe të gjetjeve të ekspertëve. Ajo u përqendruar tek integriteti i zyrtarëve të lartë dhe të zgjedhurve, te financimi i fushatave elektorale, korrupsioni transnacional, kontrolli paraprak i korrupsionit në projektaktet ligjore, rregullimi i lobimit dhe ndikimi në vendimmarrje.

Ll. M. Monika Canco, pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, bëri një prezantim të sfidave, problematikave dhe rekomandimeve kryesore të ekspertëve lidhur me parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në administratën qendrore dhe vendore. Zonja Canco u fokusua kryesisht në sektorët me risk të lartë dhe në sektorin privat, ku përfshihen dhe ndërmarrjet publike.

Përfaqësuesi i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Shqipëri, z. Ened Topi, në fjalën e tij u ndal në gjetjet dhe sugjerimet e ekspertëve pas analizimit të

funksionimit dhe efektivitetit të institucioneve përgjegjëse për luftën kundër korrupsionit, në monitorimin e menaxhimit të financave publike dhe pakësimin e rasteve të korrupsionit në qeverisjen qendrore, vendore dhe në institucionet e pavarura si dhe në parandalimin e financimeve të paligjshme dhe pastrimin e parave.

Më pas tre ekspertët dhe znj. Gjonaj iu përgjigjën pyetjeve dhe komenteve të bëra nga pjesëmarrësit lidhur me rolin e sinjalizuesve dhe nevojën e ndërgjegjësimit të shoqërisë për të parandaluar fenomenin e korrupsionit përmes denoncimit të çdo rasti korrupsioni apo favorit të çdo forme, mekanizmat për forcimin e institucioneve të pavarura për të luftuar korrupsionin, nevojën për aplikimin e deklaratës së konfliktit të interesit nga punonjësit e administratës publike, mbështetjen e grupeve të margjinalizuara për ofrimin e shërbimeve digjitale, gjetjen e mekanizmave për rritjen e ndikimit të shoqërisë civile në vendimmarrje, rritjen e besimit të qytetarëve nëpërmjet rritjes së llogaridhënies dhe transparencës së institucioneve, nevojën për të përfshirë në kurrikulat shkollore elementet e parandalimit të korrupsionit etj.

7 shkurt 2025

Sundimi i ligjit dhe funksionet e Kuvendit, gjetjet e ekspertëve të Komisionit të Posaçëm diskutohen me studentë dhe organizata të shoqërisë civile në Shkodër

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit zhvilloi forumin e tetë publik të dialogut me studentë, pedagogë dhe përfaqësues të shoqërisë civile në qytetin e Shkodrës. Rreth 45 pjesëmarrës u njohën me analizën e realizuar nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë (GENL) për shtyllën *“Sundimi i ligjit”*, metodologjinë e përdorur nga ekspertët për skanimin e situatës në drejtim të mirëqeverisjes, antikorrupsionit dhe sundimit të ligjit, masat dhe mekanizmat e sugjeruar prej tyre për t’u bërë pjesë e Planit Kombëtar të Veprimit, për të cilin po zhvillohen forumet e dialogut në disa qytete të vendit.

Deputetja Klotilda Bushka bëri një përmbledhje të punës së deritanishme të Komisionit të Posaçëm, të analizës së gjerë profesionale të bërë nga GENL-ja lidhur me shtyllën *“Sundimi i ligjit”* dhe më pas foli për nevojën për rritjen e rolit mbikëqyrës dhe monitorues të Kuvendit për të siguruar eficiencën dhe përgjegjshmërinë e institucioneve të pavarura, përputhjen e procesit të emërimit të drejtuesve të institucioneve me parimet e meritokracisë dhe transparencës etj.

Znj. Bushka i ftoi të pranishmit të përfshiheshin dhe të ishin sa më aktiv në diskutime, pasi sugjerimet e marra nga forumet e dialogut do t’i shërbejnë përmirësimit të mëtejshëm të Planit Kombëtar të Veprimit, për të cilin po punohet nga ekspertët e GENL-së.

Dr. Emilio Çika, pedagog në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë, në fjalën e tij u ndal në sfidat, problematikat dhe gjetjet e ekspertëve lidhur me rolin mbikëqyrës të Kuvendit brenda kompetencave kushtetuese për të siguruar eficiencën, transparencën, përgjegjshmërinë e institucioneve të pavarura për të ushtruar funksionet e tyre në shërbim të publikut; nevojën për përmirësimin e mbikëqyrjes parlamentare përmes dëgjësave më të shpeshta dhe krijimit të një kuadri të rregullt për të monitoruar veprimet e qeverisë; rikonfigurimin dhe zgjerimin e platformës ndërinstitucionale *on-line* për të përmirësuar transparencën dhe qasjen publike; detyrimin e institucioneve që nxjerrin rekomandime për të paraqitur dhe publikuar raporte periodike mbi progresin e zbatimit të rekomandimeve në kuadër të procesit të integritetit; rritjen e pjesëmarrjes së shoqërisë civile dhe të medias në monitorimin e zbatimit të rekomandimeve; nevojën për disa përmirësime në zgjedhjen e drejtuesve të institucioneve të pavarura, për të cilët mbeten ende sfida lidhur me meritokracinë, transparencën dhe konsensusin politik etj.

Përfaqësuesja e Qendrës për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, znj. Ilvana Dedja, bëri një prezantim të sfidave, problematikave dhe rekomandimeve kryesore të ekspertëve pas analizës së treguesve të efektivitetit, transparencës dhe llogaridhënies së Kuvendit. Disa nga sugjerimet e paraqitura nga ekspertja ishin: rritja e kapaciteteve të komisioneve parlamentare; forcimi i mekanizmave të mbikëqyrjes së Kuvendit për zbatimin e ligjeve që miraton; përforsimi i sistemit të llogaridhënies për deputetët; rritja e transparencës financiare për të shmangur problemet me menaxhimin e fondeve publike që përfiton Kuvendi; shmangia e miratimit të akteve normative për ndryshime të vazhdueshme të ligjit vjetor të buxhetit; rritja e kapaciteteve administrative etj.

Më pas ekspertët dhe znj. Bushka iu përgjigjën pyetjeve dhe komenteve të bëra nga pjesëmarrësit lidhur me nevojën e rritjes së integritetit të drejtuesve të institucioneve të pavarura; gjetjen e mekanizmave të duhur për forcimin e institucioneve të pavarura dhe rritjen e besimit të publikut në to; nevojën për përfshirjen sa më shumë të qytetarëve dhe të shoqërisë civile në procesin legjislativ, çka do të ndihmojë në rritjen e besimit të Kuvendi; mbështetjen e grupeve të ndryshme shoqërore për t'u përfshirë sa më shumë në vendimmarrje etj.

13 shkurt 2025

OGP bashkëpunon me Komisionin e Posaçëm, deputetja Milva Ekonomi takim pune në Bruksel për mirëqeverisjen

Në kuadër të punës së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit, një grup i kryesuar nga deputetja Milva Ekonomi, ekspertë të GENL-së dhe Sekretariati Teknik zhvilluan një vizitë pune në zyrat e Open Government Partnership (OGP) në Bruksel.

Në takimet me përfaqësuesit e OGP-së u diskutua rreth gjetjes së mekanizmave të bashkëpunimit në fushën e qeverisjes së hapur dhe transparencës

parlamentare dhe u propozuan disa hapa konkretë për të forcuar kornizën e mirëqeverisjes dhe për të integruar parimet e OGP-së për transparencën, llogaridhënien, integritetin dhe gjithëpërfshirjen në punën e Komisionit të Posaçëm dhe të Kuvendit.

Në këto takime u ra dakord që Open Government Partnership të ofrojë rekomandime mbi shtyllën *“Mirëqeverisja”* si dhe për përgatitjen e Planit Kombëtar të Veprimit (PKV). Gjithashtu u ra dakord që në Dokumentin Analitik të shtohet një kapitull mbi qeverisjen e hapur, duke e pozicionuar atë si një komponent kyç që lidh dhe koordinon veprimet e tri shtyllave të analizës. Për të mbështetur stafin parlamentar në zbatimin e këtyre reformave, OGP-ja do të ofrojë një paketë udhëzimesh dhe mjetesh praktike të Open Parliament për rritjen e transparencës dhe të angazhimit qytetar në proceset parlamentare.

20 shkurt 2025

Miratohet në parim Dokumenti Analitik për shtyllën “Mirëqeverisja”

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit shqyrtoi dhe miratoi në parim Dokumentin Analitik për shtyllën *“Mirëqeverisja”*, hartuar nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë (GENL). Deputetja Milva Ekonomi, anëtare e Komisionit të Posaçëm dhe relatore e kësaj shtylle, në relacionin e paraqitur në mbledhjen e Komisionit bëri një përmbledhje të metodologjisë së punës, të fazave nëpër të cilat ka kaluar analiza, procesit të konsultimeve dhe diskutimit të tij në tryezat publike të organizuara gjatë periudhës nëntor–dhjetor 2024 me rreth 150 pjesëmarrës, të forumeve me profesionistë të fushës, grupet e interesit e qytetarë si dhe me pedagogë e studentë në Durrës, Elbasan dhe Vlorë.

Deputetja Ekonomi informoi pjesëmarrësit dhe për dakordësinë e arritur me përfaqësues të OGP-së për forcimin e bashkëpunimit në fushën e qeverisjes dhe transparencës parlamentare si dhe përfshirjen në analizë të një kapitulli mbi qeverisjen e hapur, i cili është një komponent që lidh dhe koordinon veprimet e tri shtyllave të analizës.

Znj. Ekonomi sqaroi se bazuar në gjetjet e analizës dhe marrjes së komenteve nga institucionet e pavarura dhe ekzekutivi, organizatat ndërkombëtare, organizatat e shoqërisë civile, bota akademike dhe biznesi etj., grupi i ekspertëve ka nxjerrë rekomandimet kryesore si dhe drejtimet e mundshme për ndërhyrje, të cilat kanë shërbyer si bazë për ndërtimin e planit të veprimit për shtyllën *“Mirëqeverisja”*.

Gjithashtu në relacionin e saj ajo informoi se plani i veprimit për shtyllën *“Mirëqeverisja”* parashikon 23 fusha tematike me 70 masa specifike, që ndahen sipas funksioneve kryesore të Kuvendit, nga të cilat rreth 21 masa lidhen me funksionin ligjbërës dhe rreth 49 masa lidhen me funksionin mbikëqyrës dhe kontrollues të tij.

Lidhur me kapitullin për transparencën në administratën publike ekspertët kanë renditur 10 rekomandime, nga të cilat përmendim krijimin e këshillave konsultativë të përhershëm pranë Kuvendit me përfaqësues të shoqërisë civile, akademikë etj., mbështetjen e pushtetit vendor në fushën e digjitalizimit etj. Për kapitullin e integritetit dhe etikës në administratën publike znj. Ekonomi bëri të ditur se Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë ka nxjerrë katër rekomandime kryesore, ku renditet edhe nevoja për hartimin e një ligji të ri për shmangien e konfliktit të interesit për personat e emëruar që ushtrojnë funksione publike.

Për rritjen e efektivitetit dhe të transparencës në financat publike znj. Ekonomi u shpreh se janë paraqitur nëntë rekomandime. Ajo u ndal te përshtatja e legjislacionit për PPP-të dhe koncesionet sipas BE-së, përfshirja e kriterëve të respektimit të mjedisit (prokurimi *green*) në procedurat e prokurimeve publike nëpërmjet identifikimit të numrit të procedurave të prokurimit që reflektojnë kërkesat për eficiencën e energjisë, ngritja e një këshilli fiskal për raportimin e rregullt financiar të ndërmarrjeve shtetërore nëpërmjet metodologjisë së standardizimit me qëllim reduktimin e risqeve fiskale etj.

Në mbledhje ishin ftuar për t'iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve katër anëtarë të Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë: prof. dr. Migena Leskoviku, pedagoge në Institutin e Studimeve Europiane (ISE), Universiteti i Tiranës; prof. asoc. dr. Olta Milova, pedagoge në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës; z. Geron Kamberi, përfaqësues i Qendrës për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes; z. Marsel Llukmani, përfaqësues i Biznes Albania. Pas diskutimeve Komisioni i Posaçëm miratoi në parim Dokumentin Analitik për shtyllën *“Mirëqeverisja”*.

20 shkurt 2025

Miratohet në parim Dokumenti Analitik për shtyllën “Antikorrupsioni”

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit shqyrtoi dhe miratoi në parim Dokumentin Analitik për shtyllën e dytë - *“Antikorrupsioni”*. Anëtarja e Komisionit të Posaçëm Etilda Gjonaj dhe relatore e kësaj shtylle, sipas rregullores së Kuvendit, bëri një përmbledhje të Dokumenti Analitik, hartuar me një strukturë të re përmes angazhimit dhe kontributit të 41 ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë, kontributit të dhënë nga ekspertë shqiptarë që jetojnë në diasporë dhe të organizatave ndërkombëtare, procesit të konsultimit publik përmes organizimit të 6 tryezave publike si dhe 6 forumeve të dialogut qytetar në Elbasan, Vlorë, Tiranë, Shkodër dhe Berat, ku kanë marrë pjesë rreth 265 pjesëmarrës etj.

Znj. Gjonaj informoi se gjatë këtij procesi janë bërë rreth 80 komente dhe sugjerime nga aktorë të shoqërisë civile, përfaqësues të institucioneve publike, akademikë dhe studentë, si dhe janë përcjellë tri opinione me shkrim nga organizatat e shoqërisë civile, që janë përfshirë në analizë.

Në relacionin e paraqitur znj. Gjonaj theksoi se Dokumenti Analitik është hartuar duke analizuar në mënyrë shteruese dokumentet bazë, të cilat kanë shërbyer si udhërrëfyes të procesit dhe janë njëkohësisht dokumentet që përcaktojnë detyrimet e shtetit shqiptar në kuadër të procesit të negociatave për integrimin europian, duke përfshirë masat e udhërrëfyesve të shtetit të së drejtës, reformës në administratën publike dhe për funksionimin e institucioneve të pavarura. Ashtu si dhe raportet e mekanizmave ndërkombëtarë që monitorojnë progresin e Shqipërisë në këtë fushë, si ato të Këshillit të Europës, DASH, OGP, TI, UNCAC etj.

Relatorja theksoi se metodologjia e ndjekur për realizimin e kësaj analize është ndërtuar mbi një qasje të integruar, duke kombinuar metodat sasimore dhe cilësore në mbledhjen, përpunimin dhe analizën e të dhënave, si dhe duke vlerësuar praktikën më të mira ndërkombëtare dhe duke i përshtatur ato në kontekstin shqiptar. Sipas saj, një kontribut i rëndësishëm është dhënë nga konsultimi i 150 dokumenteve dhe raporteve të organizatave ndërkombëtare, shoqërisë civile dhe institucioneve publike në Shqipëri, që kanë ofruar perspektivën e tyre në kontekstin shqiptar.

Në relacionin e paraqitur theksohet se Dokumenti Analitik i integruar për shtyllën *“Antikorrupsioni”* tashmë përmban 9 fushat tematike me 241 masa specifike, përfshirë kuadrin institucional dhe rregullator për luftën kundër korrupsionit si dhe aspekte të tjera të konsideruara prioritare për një fokus të veçantë.

Në lidhje me fushën e parë tematike, që përfshin kuadrin institucional dhe rregullator, relatorja bëri të ditur se janë propozuar 11 masa politiko-strategjike me veprim horizontal rreth problematikave në arkitekturën institucionale, të cilat parandalojnë dhe luftojnë korrupsionin, por edhe në adresimin e një kuadri të ri ligjor për luftën kundër korrupsionit.

Sa i takon fushës së dytë tematike, e cila lidhet me integritetin e zyrtarëve publikë në nivelin politik dhe në atë të drejtuesve të lartë ekzekutivë në relacionin e prezantuar në Komision sqarohet se janë propozuar 42 rekomandime, disa prej të cilave synojnë zgjidhjen e problematikave të evidentuara, përfshirë konfliktin e interesave; plotësimin e mangësive ligjore dhe institucionale në fushën e deklarimit të pasurive; mungesën ligjore për çështjet e lobimit apo trajtimin e dekriminalizimit. Një nga elementet më të rëndësishme në aspektin e integritetit të zyrtarëve publikë është rishikimi i kuadrit ligjor dhe institucional për trajtimin e rasteve të sinjalizimit, që përbën një mekanizëm të rëndësishëm për denoncimin e korrupsionit.

Në kuadër të fushës së tretë tematike, që lidhet me financimin politik, janë propozuar 16 rekomandime, që shtrojnë nevojën e një kuadri të posaçëm për transparencën e financimit të partive politike, si dhe rregullime specifike në drejtim të auditimit të partive politike dhe reklamave politike në medien tradicionale e rrjetet sociale.

Sa i përket fushës së katërt tematike, e cila ka në fokus procesin legjislativ, janë formuluar rekomandime për institucionet qendrore dhe Kuvendin, me synimin rritjen e transparencës dhe të pjesëmarrjes së shoqërisë civile, por edhe moslënien e hapësirave të korrupsionit që në hartimin e ligjeve.

Lidhur me fushën e pestë tematike, kontrolli financiar dhe menaxhimi i financave publike, rekomandimet synojnë një reformim institucional dhe ligjor për përmirësimin e transparencës dhe objektivitetin në procesin e auditimit të njësive publike.

Në fushën e gjashtë tematike, e cila mbulon tregun dhe konkurrueshmërinë, masat e parashikuara shtrihen jo vetëm në sektorin privat, por edhe në institucionet rregullatore dhe monitoruese, duke mundësuar parandalimin e korrupsionit në sektorin privat.

Për fushën e shtatë tematike, e cila mbulon funksionet e qeverisjes dhe sektorët me risk të lartë korrupsioni, janë propozuar një sërë rekomandimesh, që kërkojnë një qasje sektoriale dhe masa horizontale, sic mund të jenë prokurimet publike, koncesionet dhe investimet strategjike.

Për sa i përket fushës së tetë tematike, që lidhet me pastrimin e parave, financimet e paligjshme dhe korrupsionin transnacional, rekomandimet synojnë ndërmarrjen e masave konkrete, siç mund të jenë rritja e numrit të hetimeve financiare paralelisht me hetimet e veprave penale që gjenerojnë të ardhura kriminale, forcimi i zbatimit të regjistrimit të pronarëve përfitues etj. Një fokus të posaçëm kanë pasur edhe rekomandimet lidhur me skanimin e investimeve strategjike, ku kërkohet një ndërhyrje ligjore për të parandaluar cenimin e infrastrukturës kritike nga vendet që kanë qëllime dashakeqe.

Lidhur me fushën tematike të nëntë, e cila trajton rritjen e ndërgjegjësimit dhe angazhimit shoqëror, janë rekomanduara masa që lidhen me politikbërjen dhe monitorimin e financave publike, por një rëndësi e veçantë i është kushtuar rritjes së kapaciteteve të OSHC-ve si dhe forcimit të mekanizmave mbrojtës për qytetarët që denoncojnë korrupsionin.

Në relacion theksohet gjithashtu se, pavarësisht se një ndër synimet kryesore ka qënë në drejtim të procesit të integritetit europian, kjo analizë ka dalë me një shikim përtej tyre për të ndërtuar një reformë që të ketë efektivitet në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Në mbledhje ishin të ftuar për t'iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve lidhur me analizën e bërë prej tyre disa anëtarë të Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë: prof. asoc. dr. Jonida Rustemaj, pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës; prof. asoc. dr. Ledion Shahini, pedagog në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës; znj. Ardita Seknaj, përfaqësuese e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë; Ll. M. Monika Canco, pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës.

Pas diskutimeve Komisioni i Posaçëm miratoi në parim Dokumentin Analitik për shtyllën “Antikorrupsioni”.

Gjatë muajit shkurt Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë dhe Sekretariati Teknik së bashku me deputeten Etilda Gjonaj, relatore e Komisionit për shtyllën “Antikorrupsion”, zhvilluan një sërë tryezash teknike me qëllim konsultimin e masave të parashikuara në Planin Kombëtar të Veprimit për të diskutuar gjetjet dhe zgjidhjet e propozuara lidhur me: i) kuadrin institucional dhe ligjor për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit – me ILDKPKI-në, Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit dhe Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje (10 shkurt); ii) parandalimin e financimeve të paligjshme dhe pastrimin e parave – me përfaqësues të Agjencisë së Inteligjencës Financiare, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit (13 shkurt); iii) forcimin e auditimit të brendshëm dhe të inspektimit financiar – me përfaqësues të Ministrisë së Financave (18 shkurt); iv) problematikat në sektorin e tatimeve dhe doganave – me përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (18 shkurt); për zhvillimin e sektorit të prokurimeve publike – me përfaqësues të Agjencisë së Prokurimeve Publike (21 shkurt) etj.

26 shkurt 2025

Miratohet në parim Dokumenti Analitik për shtyllën “Sundimi i ligjit”

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit shqyrtoi dhe miratoi në parim Dokumentin Analitik për shtyllën e tretë - “Sundimi i ligjit”. Deputeti Toni Gogu, relator i Komisionit për këtë shtyllë, foli për analizën e ekspertëve dhe punën e bërë prej tyre në kuadër të këtij procesi të ndërmarrë nga Kuvendi.

“Ky nuk është një raport teknik i zakonshëm. Ky është një udhërrëfyes për ndryshimin, një dokument që synon ta bëjë shtetin më të drejtë, më transparent e më të besueshëm për qytetarët. Është puna e të paktën 70 ekspertëve. Një punë që ka zgjatur 8 muaj duke analizuar çdo aspekt të sundimit të ligjit dhe janë propozuar zgjidhje konkrete”, – tha Z. Gogu. Më tej ai theksoi se ligjet që bën Kuvendi duhet të jenë më të qarta dhe të shpjegohet impakti i tyre për qytetarët.

Kuvendi transparent dhe më i përgjegjshëm, çfarë propozojnë ndër të tjera ekspertët në Planin Kombëtar të Veprimit?

1. Digjitalizimi i të gjithë procesit ligjbërës, krijimi i një sistemi elektronik që i lejon qytetarët të ndjekin në kohë reale se cilat ligje po diskutohen dhe të japin mendimin e tyre.
2. Përmirësimi i mekanizmit të raportimit të deputetëve, që qytetarët të kenë informacion të qartë për punën e tyre.

3. Zhvillimi i një platforme *on-line* për petitionet, ku çdo qytetar mund të propozojë një çështje që kërkon të diskutohet në Kuvend.

Komponenti i dytë është se si mund të mbrohen të drejtat e qytetarëve. Meqënëse një nga shqetësimet më të mëdha të qytetarëve janë problemet me të drejtat e pronës, propozimet e ekspertëve fokusohen në:

- i) përfundimin e regjistrimit fillestar të të gjitha pronave në Shqipëri deri në vitin 2030;
- ii) përdorimin e teknologjisë *Blockchain* për të siguruar transparencë dhe siguri të plotë mbi të dhënat e pronave;
- iii) përsheptimin e procesit të kompensimit të pronave të shpronësuara, duke krijuar një sistem më transparent dhe të digjitalizuar;
- iv) rritjen e sigurisë kibernetike dhe mbrojtjen e të dhënave personale sipas standardeve europiane.

Një fokus të veçantë në rekomandimet e ekspertëve lidhet me nevojën e forcimit të institucioneve që mbikëqyrin dhe mbrojnë të drejtat e qytetarëve, si Avokati i Popullit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Dokumenti Analitik për shtyllën "*Sundimi i ligjit*" është konsultuar me institucione të pavarura dhe ekzekutivin, me organizata ndërkombëtare, organizata të shoqërisë civile, me përfaqësues nga bota akademike dhe biznesi, ekspertë dhe përfaqësues të Delegacionit të BE-së, OPDAT-it, Bankës Botërore, OSBE-së, NDI-së, Këshillit të Europës, me 3 ekspertët ndërkombëtaë nga universiteti i Salentos (Itali) dhe Universiteti "Washington and Lee" (SHBA) si dhe 12 ekspertë shqiptarë të diasporës, gjyqtarë e prokurorë, pedagogë të Shkollës së Magjistraturës etj. Të gjitha komentet e përcjella nga procesi i konsultimit të shpjeguar më sipër janë shqyrtuar nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë dhe janë reflektuar në draftin final të Dokumentit.

Zoti Gogu nënvizoi se gjetjet dhe rekomandimet e Dokumentit Analitik do të shërbejnë për të hartuar planin e veprimit, i cili do të përkthehet në ndryshime ligjore dhe masa konkrete që do të zbatohen nga institucionet, si dhe theksoi nevojën e pjesëmarrjes më të madhe të qytetarëve dhe aktorëve të shoqërisë në procesin e vendimmarrjes.

Plani i veprimit për shtyllën "*Sundimi i ligjit*", si draft i parë, përmban ka 31 fusha tematike me 99 masa specifike, ku kapitulli i të drejtave të njeriut përmban 22 fusha tematike me 60 masa specifike, ndërsa kapitulli për funksionet e Kuvendit ka 9 fusha tematike me 39 masa specifike.

Sa i përket ligjit për partitë politike kryetari i Komisionit të Posaçëm, z. Fatmir Xhafaj, u shpreh se vërtet ky është një ligj i hershëm në kohë dhe në disa aspekte është pengesë, por rishikimi i tij duhet parë në përputhje me objektin e qëllimit të Komisionit. Lidhur me eficiencën e Kuvendit ai pyeti ekspertët nëse ka të bëjë me eficiencën apo jo numri i deputetëve në raport me numrin e

zgjedhësve, sistemin zgjedhor në fuqi e ndoshta edhe vendosjen e kufizimit të mandatit, në mënyrë që të mos këtë deputetë të përjetshëm për aq kohë sa nuk votohen direkt nga qytetarët me këtë sistem elektorale.

Në vijim ai shtroi për diskutim edhe propozimin për krijimin e një kuorumi më të gjerë të procesit përzgjedhës të drejtuesve të institucioneve të pavarura. Për këto çështje ekspertët dhe anëtarët e Komisionit shkëmbyen mendime dhe propozuan modele të ndryshme, si ai francez, kroat etj.

Të ftuar për prezantimin e gjetjeve kryesore dhe masave të Planit Kombëtar të Veprimit si dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve ishin anëtarët e GENL-së: prof. dr. Aurela Anastasi, pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës; prof. as. dr. Nadia Rusi, pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës; z. Oltion Dano, përfaqësues i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë; Phd. Mariel Frroku, pedagog në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës; z. Gledis Gjipali, përfaqësues i Lëvizjes Europiane në Shqipëri (EMA); znj. Ina Xhepa, përfaqësuese e Qendrës për Zhvillim dhe Integrim Europian (CEDI); dr. Emilio Çika, pedagog në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë; z. Alket Jaupi, përfaqësues i Avokatit të Popullit; znj. Besa Velaj dhe znj. Elona Hoxhaj, përfaqësuese të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Pas diskutimeve Komisioni i Posaçëm miratoi në parim Dokumentin Analitik për shtyllën “*Sundimi i ligjit*”.

26 shkurt 2025

Miratohet kërkesa për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së Komisionit të Posaçëm

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit miratoi kërkesën e Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë dhe Sekretariatit Teknik, prezantuar nga znj. Leterije Luzi, drejtuese e Sekretariatit Teknik, për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së këtij Komisioni deri në datën 30 korrik 2025 për t'iu lënë kohë në dispozicion ekspertëve të shqyrtojnë dhe reflektojnë sugjerimet dhe komentet e përfuara gjatë diskutimeve teknike për përfundimin e Planit Kombëtar të Veprimit për të tria shtyllat. Kërkesa e miratuar nga Komisioni i Posaçëm do t'i kalojë për shqyrtim Konferencës së Kryetarëve dhe më pas seancës plenare për vendimin përfundimtar.

Kryetari i Komisionit, z. Fatmir Xhafaj, informoi Komisionin se ka përfunduar drafti i parë i analizës për komponentin e tretë në shtyllën e tretë, që lidhet me konsolidimin e reformës në drejtësi, bashkë me tetë anekset me profilet institucionale të institucioneve të drejtësisë. Dokumentet janë ende në proces pune dhe diskutimi me grupet e ekspertëve të nivelit të lartë, përfaqësuesit e institucioneve të pavarura dhe grupeve të interesit të atashuara pranë Komisionit

të Posaçëm Parlamentar dhe gjatë muajit mars do punohet që të finalizohen për t'ju nënshtruar procesit të konsultimit publik.

28 shkurt 2025

“Antikorrupsioni”, deputetja Gjonaj dhe ekspertë të Komisionit të Posaçëm takime në Komisionin Europian

Në kuadër të punës së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit, në datat 25 dhe 26 shkurt 2025 deputetja Etilda Gjonaj, ekspertët prof. asoc. dr. Jonida Rustemaj dhe Ll. M. Monika Canco si dhe znj. Esmeralda Dida, koordinatore e Sekretariatit Teknik për shtyllën “Antikorrupsioni”, zhvilluan dy takime pune në Komisionin Europian (Bruksel) me znj. Valentina Supert, drejtore për Ballkanin Perëndimor, me z. Giulio Venneri, zëvendës drejtor për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut në Drejtorinë e Përgjithshme për Zgjerimin dhe Fqinjësinë Lindore (DG ENEST), si dhe me znj. Irena Moozová, zëvendës drejtore e përgjithshme për politikën e drejtësisë, sundimit të ligjit dhe barazisë në Drejtorinë e Përgjithshme për Drejtësinë dhe Konsumatorët (DG JUST). I pranishëm ishte dhe ambasadori i Misionit të Shqipërisë në Bruksel, z. Ferit Hoxha. Deputetja Etilda Gjonaj dhe znj. Jonida Rustemaj, drejtuese e GENL-së për shtyllën “Antikorrupsioni”, prezantuan punën e deritanishme të Komisionit të Posaçëm Parlamentar në fushën e mirëqeverisjes, antikorrupsionit dhe sundimit të ligjit.

Prof. asoc. dr. Jonida Rustemaj informoi mbi metodologjinë e ndjekur për hartimin e Dokumentit Analitik dhe të Planit Kombëtar të Veprimit, gjithëpërfshirjen e ekspertëve shqiptarë të diasporës dhe ata ndërkombëtarë si dhe për zhvillimin e një procesi të gjerë konsultimi publik me shoqërinë civile dhe grupet e interesit për shtyllën “Antikorrupsioni”.

Përfaqësuesit e Komisionit Europian vlerësuan progresin e Shqipërisë dhe angazhimin për të çuar përpara luftën kundër korrupsionit në këtë fazë të rëndësishme të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Europian si dhe iniciativat për të thelluar më tej reformat ekzistuese për përmbushjen e kriterëve të grupkapitullit të parë, “Themeloret”. Ata mirëpritën vijimin e diskutimeve dhe bashkëpunimin e mëtejshëm për të përmirësuar rezultatet e punës së Komisionit të Posaçëm Parlamentar.

Gjatë takimeve u nënvizua rëndësia e bashkëpunimit të ngushtë të Shqipërisë me Bashkimin Europian dhe vijimi i reformave në përputhje me angazhimet e shtetit shqiptar për përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit në BE.

Çfarë pritet të ndodhë gjatë muajit mars me agjendën e Komisionit?

Edhe gjatë muajit mars 2025 Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit do të vijojë punën për përmbushjen e qëllimeve të tij dhe avancimin me procesin reformues sipas tri shtyllave. Bashkë me ekspertët e nivelit të lartë do të vijojë procesi i konsultimeve me grupet e interesit, përfshirë institucionet shtetërore dhe agjencitë ekzekutive ligjzbatuese, si dhe ekspertë e konsulentë ndërkombëtarë për finalizimin e Planit Kombëtar të Veprimit, ku do të përcaktohen masat konkrete legjislative dhe institucionale për ndërhyrje në legjislacion dhe në fushën e zbatimit të ligjit.

Gjatë muajit mars ekspertët e nivelit të lartë dhe anëtarët e Sekretariatit Teknik të përfshirë në procesin për komponentin e tretë të shtyllës së tretë, që lidhet me konsolidimin e reformës në drejtësi, do të vazhdojnë punën në tavolinë për hartimin e analizës bashkë me tetë anekset me profilet institucionale të institucioneve të drejtësisë si dhe për përgatitjen e planit të veprimit për këtë fushë.

Krahas punës së pavarur të ekspertëve Komisioni i Posaçëm do të zhvillojë edhe mbledhjet e tij periodike për miratimin e Dokumentit Analitik dhe miratimin në parim të Planit Kombëtar të Veprimit.

Komisioni i Posaçëm Parlamentar



KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR

**“PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR MIRËQEVERISJEN,
SUNDIMIN E LIGJIT DHE ANTIKORRUPSIONIN PËR
SHQIPËRINË 2030 NË BASHKIMIN EUROPIAN”**